



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 14/ 2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nenad Lazic, kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi për apelin e Adnan Rustemit anëtarë i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV), paraqitur kundër vendimit të datës 13.02.2014 me nr. 332/2014 të KQZ-së, për shkak të Certifikimit të Listës Përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Mitrovicës të Veriut, në seancën e panelit të mbajtur me 18.02.2014, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Adnan Rustemit anëtarë i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV), paraqitur kundër vendimit të datës 13.02.2014 me nr. 332/2014 të KQZ-së

Arsyetim

PZAP-i, me datën 14.02.2014, ka pranuar një ankesë, nga Adnan Rustemi anëtarë i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV), në Prishtinë në të cilën thekson se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve KQZ ka marr vendim me datë 13.02.2014, nr. të protokollit 332-2014, me të cilën ka certifikuar Listën Përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Mitrovicës së Veriut që do të mbahen më 23.02.2014, në shkresën në të cilën i është bashkangjitur edhe një tabelë që përmban 6684 emra të personave të cilët nuk figurojnë në Listën Preliminare të Votuesve, ku këta emra janë bashkangjitur në ekstraktin e dytë që e ka pranuar KQZ-ja nga Agjencia e Regjistrimit Civil e që nuk janë qytetar të Republikës së Kosovës, ashtu që sipas parashtruesit të ankesës me vendimin e lartpërmendur është certifikuar Lista Përfundimtare e Votuesve e cila krahas 21745 personave me të drejtë vote e që janë shtetas të Republikës së Kosovës është futur edhe një tabelë shtesë e cila përfshinë gjithsejtë 6684 persona që nuk janë shtetas të Kosovës.

Parashtruesi i apelit shton se certifikimi i kësaj LPV-je, ku gjenden edhe emrat e 6684 personave të cilëve ju njihet e drejta e votës është në kundërshtim me kushtetutë dhe ligjin dhe se mbi këtë bazë kërkon që ankesa të miratohet dhe se KQZ-ja të rishqyrtoj vendimin 332-2014 të datës 13.02.2014.

Parashtruesi i apelit ka, bashkangjitur si provë vendimin e lartpërmendur të KQZ-së, dhe Listën Përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicën e Veriut.

PZAP-i, në kuptim të nenit 10 paragrafi 1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në më datën 18.02.2014, për apelin dhe ka kërkuar që të përgjigjet. KQZ-ja në përgjigje ndaj apelit të lartpërmendur ka theksuar se Divizioni i Shërbimit të Votuesve i Sekretariatit të KQZ-së, me datë 21.01.2014, ka pranuar ekstraktin e parë të Regjistrimit Civil, ndërsa me 28.01.2014 nga Agjencioni i Regjistrimit Civil (ARC), ka pranuar ekstraktin e Regjistrimit Qendror Civil, në të cilin janë përfshirë 12 mijë persona të cilët nuk janë përfshirë në tabelën me të dhënat e qytetarëve të Kosovës në Regjistrin Qendror Civil, por janë përfshirë vetëm në një tabelë të veçantë. Mëtej në përgjigje ndaj apelit theksohet se KQZ-ja ka kërkuar me datë 28.01.2014 nga ARC-ja, të sqaroj se këta 12 mijë persona qytetarë të Republikës së Kosovës dhe të regjistruar në Regjistrin Qendror Civil dhe po ashtu kanë kërkuar që të ndahen këta persona vetëm për Mitrovicën e Veriut. Ndërsa më datë 29.01.2014, KQZ-ja ka pranuar një përgjigje nga ARC-ja me nr. 1582/2014 në të cilën kanë theksuar se në numrin 12 mijë persona janë të përfshirë edhe 6684 persona të komunës së Mitrovicës së Veriut dhe janë pjesë e ekstraktit të fundit të Regjistrimit Qendror Civil.

PZAP-i, pas administrimit të pretendimeve ankimore, vendimit kontestues të datës 13.02.2014 me numër të protokollit 332-2014 të KQZ-së, Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV) për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicën e Veriut dhe Përgjigjen në apel të KQZ-së me nr. 345/A-2014 e datës 18.02.2014 gjeti se:

Apeli është i pabazuar.

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

Parashtruesi i apelit pretendon se Certifikimi i LPV-së, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicën e Veriut në të cilën gjendet tabela shtesë në ekstraktin e dytë që gjenden edhe 6684 emra të votuesve të cilët nuk janë qytetarë të Kosovës. Sipas parashtruesit të apelit lista e lartpërmendur bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës konkretisht kapitullin për të “*Drejtat dhe Lirit Themelore*” si dhe me legjislacionin në fuqi.

Nga LPV-ja, rezulton se për tabelën e veçantë që i është bashkangjitur LPV-së me ekstraktin e dytë në të cilën gjenden edhe 6684 emra të personave të cilët janë pjesë e Regjistrimit Qendror Civil të Republikës së Kosovës, të cilët janë të Komunës së Mitrovicës së Veriut dhe kanë të drejtën të votës me këtë konfirmohet edhe nga shkresa e Agjencionit Qendror Civil (ARC) me nr.177/A-2014.

Në përgjigje të KQZ-së me nr.345/A-2014 e datës 18.02.2014, theksohet se: Divizioni i Shërbimit të Votuesve i Sekretariatit të KQZ-së, me datë 21.01.2014, ka

pranuar ekstraktin e parë të Regjistrimit Civil, ndërsa me 28.01.2014 nga Agjencioni i Regjistrimit Civil (ARC), ka pranuar ekstraktin e Regjistrimit Qendror Civil, në të cilin janë përfshirë 12 mijë persona të cilët nuk janë përfshirë në tabelën me të dhënat e qytetarëve të Kosovës në Regjistrin Qendror Civil, por janë përfshirë vetëm në një tabelë të veçantë. Mëtej në përgjigje ndaj apelit theksohet se KQZ-ja ka kërkuar me datë 28.01.2014 nga ARC-ja, të sqaroj se këta 12 mijë persona qytetarë të Republikës së Kosovës dhe të regjistruar në Regjistrin Qendror Civil dhe po ashtu kanë kërkuar që të ndahen këta persona vetëm për Mitrovicën e Veriut. Ndërsa më datë 29.01.2014, KQZ-ja ka pranuar një përgjigje nga ARC-ja me nr. 1582/2014 në të cilën kanë theksuar se në numrin 12 mijë persona janë të përfshirë edhe 6684 persona të komunës së Mitrovicës së Veriut dhe janë pjesë e ekstraktit të fundit të Regjistrimit Qendror Civil.

Pretendimet ankimore të palës ankuese se 6684 emra të personave që i janë bashkangjitur LPV-së, janë të pa bazuara me arsyetim se vendimi i KQZ-së me nr.332/2014 të datës 13.02.2014 për Certifikimin e LPV-së për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme në Mitrovicën e Veriut, është bazuar në ekstraktin e fundit të marrë nga ARC-ja, i cili është organ kompetent për mirëmbajtjen e Regjistrimit Qendror Civil të cilat te dhëna supozohet se janë sakta.

Andaj, bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në të cilin theksohet se: *PZAP-i refuzon apelin të cilat nuk i përmbushin standardet*, prandaj bazuar në dispozitat e nenit të cekur më lart u vendosi si në dispozitivë të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 14/2014 më datën 18.02.2014.

**Kryesuesi i Panelit
Nenad Lazic d.v**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.